



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 6

Dt. 13 02. 2017

PËR MIRATIMIN E KËRKESËS
“PËR PËRDORIMIN E BURIMEVE UJORE “

Në mbështetje të nenit 7, nenit 38 “Qëllimet e përdorimit të ujit” gërma c ; nenit 41, “Përdorimi me leje i ujit” gërmat a dhe d ; nenit 50; nenit 51; nenit 52 dhe nenit 53 të ligjit nr. 111/2012 datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore “ dhe të VKM Nr.416 datë 13.05.2015, “ Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje për përdorim të burimeve ujore”, bazuar në relacionin e paraqitur nga A.B.U. Drin - Bunë , miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponentës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë :


V E N D O S I :

- 1- Të miratojë kërkesën e subjektit “KOLA” shpk me administrator **Z. Nikoll KOLA** për përdorimin e burimit ujor Shkalla e Firës në fshatin Qelëz , Njësia Administrative Qelëz, Bashkia Pukë, Qarku Shkodër,për stabilimentin “MIDA” të ambalazhimit të ujit në shishe dhe enë.
Vepra e marrjes ka koordinatat: X -44 14298.2; Y – 46 64 722.9; Z – +1441m;
Prurja mesatare vjetore e burimit është 0.001552 m³/sek.
Prurja mesatare e muajit më të thatë është 0.00111 m³/sek.
Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti është 11.6 m³/ditë .
- 2- Leja e përdorimit të burimit ujor jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.
- 3- Ngarkohet A.B.U. Drin- Bunë për ndjekjen e procedurave përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR

Martin PLLUMBI



KRYETAR

Paulin RADOVANI

